

## Deklaratë për Shtyp



# BANKA E SHQIPËRISË

Zyra e Shtypit  
4 korrik 2007

### 1. NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË

#### 1.1. Operacionet e tregut të hapur.

DATA	Injektivim likuiditeti	Tërheqje likuiditeti			
	R/REPO njëjavë	REPO njëjavë	REPO njëmuaj	REPO tremuaj	Ulje e portofolit të bonove të thesarit të BSH
04.01.2007	0.00				
11.01.2007		11,630.00			
18.01.2007		8,710.00			
25.01.2007		10,380.00			
01.02.2007		8,325.00			
08.02.2007		7,750.00		1,500.00	
15.02.2007		6,950.00			
22.02.2007		5,565.00	400.00		
01.03.2007		4,700.00			
08.03.2007		6,120.00		450.00	
15.03.2007		2,305.00			2,500.00
23.03.2007		2,370.00			
29.03.2007		1,090.00			

Pas mungesës së likuiditetit të krijuar në sistemin bankar në tremujorin e fundit të vitit 2006, tremujori i parë i vitit 2007 u karakterizua nga tepricë e lartë e likuiditetit. Për të administruar tepricën e lartë të likuiditetit, Banka e Shqipërisë krahas ndërhyrjeve aktive për tërheqjen e likuiditetit nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes, tërhoqi likuiditet edhe nëpërmjet maturimit të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes të përdorura gjatë gjysmës së dytë të vitit 2006.

Shuma totale e likuiditetit, e tërhequr nëpërmjet maturimit të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes ishte 8.85 miliardë lekë.

**Tabelë 1:** Vëllimi i operacioneve të tregut të hapur (në milionë lekë).

Ndërhyrja aktive me marrëveshje riblerjeje për tërheqjen e likuiditetit të tepërt në sistemin bankar, përfshiu të gjithë gamën e instrumenteve të tregut të parasë. Konkretisht, nëpërmjet

instrumentit kryesor të tregut, *marrëveshje riblerjeje me maturim njëjavor*, u tërhoqën mesatarisht 6.32 miliardë lekë në javë.


Krahas ndërhyrjeve me instrumentin kryesor, për tërheqjen e likuiditetit u përdorën edhe marrëveshjet e riblerjes me afat më të gjatë maturimi. Nëpërmjet *marrëveshjes së riblerjes me maturim njëmuajor* u tërhoqën 0.40 miliardë lekë, ndërsa nëpërmjet *marrëveshjes së riblerjes me afat maturim tremujor* u tërhoqën rreth 1.95 miliardë lekë, ndërkohë që u realizua edhe tërheqja e likuiditetit në mënyrë të përhershme për 2.5 miliardë lekë, nëpërmjet *uljes së portofolit të bonove të thesarit të Bankës së Shqipërisë*.

## 1.2 Përdorimi i instrumenteve mbështetëse.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2007, për investimin e likuiditeteve të lira, bankat përdorën depozitën njëditore, niveli mesatar ditor i së cilës ishte 1,640 milionë lekë në krahasim me 4,803 milionë lekë në tremujorin e kaluar. Ulja e nivelit të depozitës ishte rezultat i ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë për tërheqjen e likuiditetit me instrumentet e tregut të hapur. Në kushtet e plotësimit të nevojave në tregun ndërbankar, instrumenti i kredisë njëditore gjeti përdorim minimal gjatë tremujorit të katërt të vitit 2006, rreth 0.3 miliardë lekë në 8 raste përdorimi.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblendhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë tremujorit të fundit të vitit 2006 dhe tremujorit të parë të vitit 2007.

**Grafik 1:** Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë tremujorit të fundit të vitit 2006 dhe tremujorit të parë të vitit 2007.



## 2. NDËRHJRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

### 2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë.

Banka e Shqipërisë nuk ka qenë e pranishme në tregun e brendshëm valutor gjatë tremujorit të parë të vitit aktual.

### 2.2 Veprime të tjera.

Gjatë kësaj periudhe kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Vëllimi i shitjeve të valutës ka qenë 6,978.34 milionë lekë. Si zakonisht, edhe gjatë këtij tremujori, kanë vijuar shitjet e valutës që përcaktohen nga detyrimi i Qeverisë Shqiptare për shlyerjen e kësteve të borxhit të jashtëm.

Vëllimi i blerjeve me Ministrinë e Financave për tremujorin e parë të vitit ka qenë 2,689.05 milionë lekë, ndërsa blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 47.46 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim, IDA dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, IBRD). Tabela më poshtë jep në mënyrë të përmbledhur veprimet e kryera gjatë kësaj periudhe.

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE	2,689.05	6,978.34
TË TJERA (IDA, IBRD)	47.46	-